

VENDIM
Nr. 238, datë 20.4.2022

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT TË INSTITUTIT TË POLICISË SHKENCORE DHE
CAKTIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT SI
NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 117/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objektit të Institutit të Policisë Shkencore, në masën 653 582 498 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tre milionë e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2022, për Ministrinë e Brendshme, në programin buxhetor “Policia e Shtetit” 03440, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, shtohet fondi prej 130 716 500 (njëqind e tridhjetë milionë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh pa TVSH, për financimin e rindërtimit të objektit të Institutit të Policisë Shkencore.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit caktohet si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të objektit të Institutit të Policisë Shkencore.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama